



**RREGULLORE NR. 04/2025 PËR ZBATIMIN E AKTIVITETEVE  
TË MARKETINGUT NË TRAFIKUN URBAN – PRISHTINË**

Në bazë të nenit 20 të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, në bazë të nenit 130 të Ligjit Nr. 06-L-016 për Shoqëritë Tregtare, Statutit të Ndërmarrjes Publike Komunale “Trafiku Urban” SH.A. Prishtinë, Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e mbajtur me datë 30.05.2025 miratoi këtë:

## **RREGULLORE NR. 04/2025 PËR ZBATIMIN E AKTIVITETEVE TË MARKETINGUT NË TRAFIKUN URBAN – PRISHTINË**

### **Neni 1 Qëllimi**

Kjo rregullore përcakton rregullat për organizimin, zbatimin dhe kontrollin e aktiviteteve të marketingut dhe reklamimit në autobusët e ndërmarrjes publike “Trafiku Urban” në Prishtinë. Qëllimi është maksimizimi i shfrytëzimit të hapësirave për komunikim të dobishëm publik dhe përfitim ekonomik, duke respektuar legjislacionin në fuqi.

### **Neni 2 Fushëveprimi**

Kjo rregullore zbatohet nga ndërmarrja publike “Trafiku Urban” SHA, bashkëpunëtorët e jashtëm siç janë subjektet private dhe publike që realizojnë veprimtari marketingu dhe reklamimi brenda dhe jashtë autobusëve të ndërmarrjes.

### **Neni 3 Format e Marketingut**

3. Me qëllim të shfrytëzimit të hapësirave të brendshme dhe të jashtme të autobusëve të NPK “Trafiku Urban “ SHA, marketingu do të realizohet në një të njënjë prej formave si në vijim :

- 3.1 Brendimi i jashtëm i autobusëve në përputhje me kriteret ligjore të përcaktuara sipas kontratës PSC.
- 3.2 Reklama në monitorë brenda autobusëve.
- 3.3 Reklama përmes rrjetit Wi-Fi të autobusit.
- 3.4 Reklamimi përmes aplikacioni mobil të Trafikut Urban.

#### Neni 4 Brendimi i Jashtëm i Autobusëve

4. Autobusët e NPK “Trafiku Urban” SHA, përmes operatorit ekonomik të kontraktuar do të realizojnë brendimin e jashtëm bazuar në kriteret e mëposhtme:

- 4.1 Mbulimi maksimal i sipërfaqes së jashtme të autobusit nuk duhet të kalojë 70%.
- 4.2 Numri i linjës dhe destinacioni duhet të jenë të dukshëm.
- 4.3 Ngjyra e verdhë standarde e autobusëve duhet të jetë dominante.

#### Neni 5 Marketingu i Brendshëm në Autobusë

5. Operatori Ekonomik i kontraktuar do të realizojë shërbimet e marketingut të brendshëm si në vijim :

- 5.1 Autobusët e NPK “Trafiku Urban” SHA do të pajisen me monitorë me teknologji të avancuar në të cilët do të shfaqet një kombinim i njoftimeve të Trafikut Urban si dhe marketingut komercial sipas kontratës.
- 5.2 Reklamata brenda monitorëve duhet të jenë vizualisht të pranueshme dhe të pozicionuara strategjikisht.
- 5.3 Përmbajtja nuk duhet të jetë politike, fetare, diskriminuese apo e papërshtatshme për publikun e gjerë.
- 5.4 Monitorët e vendosur brenda autobusëve duhet të mundësojnë ndarjen e përmbajtjes në raportin 70% për përmbajtjen e ofruar nga OE dhe 30% për informimin e udhëtarëve si dhe njoftime të tjera përfshirë treguesit e linjave, vendndodhjen aktuale dhe stacionin e radhës, me qëllim përmirësimin e përvojës së udhëtimit dhe informimit publik.
- 5.5 Reklamata nuk duhet të shkaktojnë dhe as të krijojnë mundësi për shkaktimin e ndonjë dëmi material apo cenimi të imazhit, dinjitetit dhe reputacionit të Autoritetit Kontraktues.
- 5.6 Trafiku Urban ka të drejtën për të refuzuar ose ndërprerë çdo fushatë reklamuese që është në kundërshtim me politikat publike, moralin shoqëror ose rregullat e ndërmarrjes.
- 5.7 Në rastet kur, sipas vlerësimit të arsyeshëm të Autoritetit Kontraktues, përmbajtja e reklamave të vendosura në autobusët e kontraktuar nuk përputhet me legjislacionin në fuqi, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të kërkojë nga OE largimin e menjëhershëm të njësisë reklamuese përkatëse nga autobusët.

## Neni 6 Marketingu përmes aplikacionit të Trafikut Urban

6. Aplikacioni zyrtar i ndërmarrjes “Trafiku Urban” mund të përdoret për shfaqjen e përmbajtjes së marketingut dhe njoftimeve promovionale, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e konsumatorëve dhe të dhënave personale.

6.1 Reklamimi në aplikacion duhet:

- 6.1.1 Të mos cenojë privatësinë e përdoruesit;
- 6.1.2 Të jetë i përshtatshëm për të gjitha grup moshat dhe i pranueshëm në aspektin etik e shoqëror;
- 6.1.3 Të integrohet në mënyrë të tillë që nuk dëmton funksionalitetin kryesor të aplikacionit.

## Neni 7 Marketingu përmes rrjetit Wi-Fi në autobusë

7.1 Trafiku Urban, përmes kontraktimit të një Operatorit Ekonomik të licencuar, mundëson realizimin e marketingut përmes platformës së rrjetit Wi-Fi të instaluar në autobusë.

7.2 OE është përgjegjës për:

- 7.2.1 Menaxhimin teknik dhe funksional të platformës reklamuese brenda rrjetit Wi-Fi;
- 7.2.2 Ruajtjen e privatësisë së përdoruesve, në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- 7.2.3 Ndalohet mbledhja apo përdorimi i të dhënave personale pa pëlqim të qartë nga përdoruesi. Të gjitha format e targetimit duhet të jenë transparente dhe të miratuara paraprakisht nga Trafiku Urban;
- 7.2.4 OE është i detyruar të dorëzojë raporte mujore për përmbajtjen, performancën dhe incidentet teknike, si dhe të pranojë raporte të rregullta nga komisioni përkatës i Ndërmarrjes.

## **Neni 8**

### **Procedura e Miratimit dhe Mbikëqyrjes**

- 8.1 Operatori Ekonomik, i përzgjedhur përmes thirrjes publike, është përgjegjës për zhvillimin dhe zbatimin e plotë të aktiviteteve të marketingut, përfshirë krijimin e përmbajtjes grafike dhe planifikimin e fushatave.
- 8.2 Zyra e Marketingut është përgjegjëse për menaxhimin e kontratës.
- 8.3 Vendimi për miratim të përmbajtjes lëshohet nga Menaxheri i Kontratës dhe Kryeshefi Ekzekutiv i Ndërmarrjes.
- 8.4 Ndërmarrja nuk ndërhyt në aspektin kreativ apo komercial të përmbajtjes, përveç rasteve kur ka shkelje të ligjit, moralit publik apo kësaj rregullore.

## **Neni 9**

### **Pagesa dhe Kohëzgjatja e Kontratës**

- 9.1 Operatori Ekonomik i kontraktuar për aktivitetet e marketingut është i obliguar të bëjë pagesat në bazë të kontratës dhe sipas tarifave të përcaktuara nga Trafiku Urban, të miratuara nga Bordi i Drejtorëve.
- 9.2 Çmimi bazë për një autobus, përfshirë të gjitha format e marketingut (brendim, Wi-Fi, aplikacion, monitorë ). Vlera fillestare e çmimit minimal (çmimi dysHEME) është 600.00 euro(me TVSH) për njësi.(autobus)
- 9.3 Kohëzgjatja e kontratës për shfrytëzimin e hapësirave për marketing nuk mund të kalojë periudhën maksimale prej 5 viteve me mundësi vazhdimi edhe për 5 vite tjera pas vlerësimit të performancës së operatorit ekonomik dhe analizës së tregut.
- 9.4 Pagesat mujore kryhen nga OE brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e lëshimit të faturës nga Trafiku Urban.
- 9.5 Në rast të vonesës së pagesës, zbatohen tarifa ndëshkuese prej 0.25% në ditë të aplikuara mbi vlerën e papaguar, deri në maksimum 30 dite pas kalimit të afatit ligjor për pagesë të cilat do të përcaktohen në kontratë.

## Neni 10 Aktivitetet Sensibilizuese dhe për Interes Publik

- 10.1 Komuna e Prishtinës dhe Ndërmarrja Publike “Trafiku Urban” kanë të drejtë të përdorin deri në 180 (njëqind e tetëdhjetë) minuta në ditë për transmetimin e përmbajtjeve me karakter informues, edukativ apo sensibilizues në monitorët brenda autobusëve.
- 10.2 Këto minuta transmetimi nuk përbëjnë objekt tregtimi dhe nuk përfshihen në marrëveshjet komerciale të Operatorit Ekonomik. Ato menaxhohen nga Trafiku Urban në koordinim me Komunën dhe nuk i nënshtrohen tarifimit.
- 10.3 Përparësi u jepet temave që kanë të bëjnë me edukimin qytetar, sigurinë rrugore, përfshirjen sociale, njoftime zyrtare të Komunës dhe çështje të interesit të përgjithshëm.
- 10.4 Operatorit Ekonomik i kërkohet të sigurojë kapacitetin teknik dhe hapësirat e nevojshme për implementimin korrekt dhe pa ndërprerje të këtyre fushatave.

## Neni 11 Monitorimi dhe Raportimi

- 11.1 Vlerësimi mujor i zbatimit të kontratës realizohet nga Menaxheri i Kontratës dhe i dorëzohet Kryeshefit Ekzekutiv.
- 11.2 Raportimi tremujor mbi implementimin e kontratës përpilohet nga Menaxheri i Kontratës dhe i dorëzohet Kryeshefit Ekzekutiv i cili e paraqet në menaxhment për diskutim.

## Neni 12 Masat Ndëshkuese

- 12.1 Ndaj subjekteve kontraktuese që shkelin detyrimet e përcaktuara në kontratë, mund të ndërmerren masat ndëshkuese si në vijim:
  - 12.1.1 Paralajmërim me shkrim;
  - 12.1.2 Tarifat Ndëshkuese;
  - 12.1.3 Ndërprerje e njëanshme e kontratës.

### Neni 13 Thirrja Publike

- 13.1 Vendimi për iniciimin e thirrjes publike merret nga Bordi i Drejtorëve, pas shqyrtimit të analizës së tregut dhe nevojave të ndërmarrjes, në përputhje me planin e marketingut të miratuar.
- 13.2 Thirrja publike hartohet dhe shpallet në harmoni me Planin e Marketingut të “Trafikut Urban” dhe me politikat e komunës, pas:

13.2.1 Vendimit të Bordit Drejtues për aprovimin e shpalljes.

13.2 Afati i hapjes së thirrjes publike duhet të jetë:

- Jo më pak se 15 ditë kalendarike, dhe
- jo më shumë se 30 ditë kalendarike, duke filluar nga dita e publikimit.

### Neni 14 Orari i Operimit

14.1 Autobusët e Trafikut Urban operojnë çdo ditë nga ora 06:00 deri në 24:00, në përputhje me orarin zyrtar të linjave, i cili miratohet nga Komuna e Prishtinës dhe publikohet për informimin e qytetarëve.

14.2 Çdo ndryshim në orar bëhet vetëm me vendim të autoritetit komunal përkatës dhe pas njoftimit zyrtar publik.

### Neni 15 Siguria dhe Integriteti

15.1 Operatori Ekonomik (OE) është i obliguar të sigurojë që aktivitetet e reklamimit të mos paraqesin asnjë rrezik për sigurinë fizike të udhëtarëve, stafit operativ apo për integritetin e mjeteve të transportit dhe rrjetit rrugor.

15.2 Çdo material apo pajisje e përdorur për qëllime marketingu nuk duhet të pengojë qarkullimin e udhëtarëve, hyrje-daljet në autobus apo të cenojë komoditetin dhe funksionalitetin e shërbimit publik të transportit.

### Neni 16 Mirëmbajtja e Reklamave

- 16.1 Operatori Ekonomik (OE) është i obliguar të sigurojë mirëmbajtjen e rregullt dhe në kushte optimale të të gjitha materialeve reklamuese të vendosura në mjetet e transportit urban dhe në hapësirat përkatëse.
- 16.2 Çdo defekt teknik, dëmtim fizik apo degradim vizual që cenon funksionalitetin apo estetikën e reklamës duhet të identifikohet dhe të riparohet brenda afatit maksimal prej 48 orësh nga momenti i evidentimit.

### Neni 17 Instalimi dhe Brendimi i Autobusëve

Për shkak të orarit të operimit të rregullt të autobusëve, nga ora 06:00 deri në 24:00, Operatori Ekonomik (OE) është i obliguar që të kryejë të gjitha aktivitetet e instalimit dhe brendimit të materialeve reklamuese gjatë orëve të natës, pas përfundimit të orarit të shërbimit, në mënyrë që të mos pengohet funksionimi i transportit publik dhe qarkullimi i udhëtarëve.

## DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

### Neni 18

- 18.1 Në asnjë rast, dispozitat e kësaj Rregullore nuk mund të jenë më pak të favorshme për palët kontraktuese, se dispozitat e ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.
- 18.2 Për çdo paqartësi apo konflikt të dispozitave të kësaj rregulloreje, Ligjet në fuqi dhe Statuti i Ndërmarrjes mbizotërojnë mbi këtë rregullore. Në raste të tilla dispozitat përkatëse të kësaj rregulloreje konsiderohen të revokuara ose ndryshuara në masën e nevojshme për eliminimin e mos përputhjes me ndonjë dispozite të Ligjeve apo Statutit të Trafikut Urban.

### Neni 19 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryesuesi i Bordit, pas aprovimit paraprak nga ana e Bordit të Drejtorëve.

Kryesues i Bordit të Drejtorëve  
Ylber Çitaku



NDK  
"TRAFIKU URBAN"  
SH.A.  
PRISHTINË  
MUNICIPALITY PUBLIC ENTERPRISE